

Dr. Musli Vërbani

**Tregime nga Kur'ani dhe jeta e
pejgamberëve
2**

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime nga Kur'ani dhe jeta e peygamberëve 2


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:


Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime nga Kur'ani dhe jeta e pejgamberëve

2



Ibrahimi a.s. ka lindur në Babiloni.
Babilonia është saktësisht në Sirinë e sotme.
Ibrahimi a.s. në moshën rinore filloi të hulumtojë krijimin e njeriut.
Ibrahimi a.s. në moshën rinore filloi të hulumtojë krijimin e gjithësisë.
Ibrahimi a.s. në moshën rinore filloi të hulumtojë krijimin e çdo gjëje që e rrethonte.
Dëshironte të gjente përgjigje të vërtetë dhe të saktë.
Dëshironte ta kuptonte Krijuesin e vërtetë dhe absolut.

Shikoi në qiell, e pa një yll. Mendoi. - Ky është Zoti im.
Kur ylli perëndoi dhe humbi, tha:
- Ky është mendim i gabuar sepse Zoti nuk zhduket kurrë.

Shikoi prapë në qiell, e pa hënë, a mos është ky Zoti im?
- Ky është më i madh – tha në vetvete.
Edhe Hëna humbi.
- Jo – tha. - Edhe ky nuk mund të jetë Zot.

Shikoi në qiell, e pa diellin. - Ky është më i madhi - tha - ndoshta ky është Zoti im.
Perëndoi edhe dielli.
Atëherë u bind se as dielli, as hëna, as yjet nuk janë zota, por këto janë krijesa të Zotit.

Zoti është Krijuesi i gjithësisë, i gjithçkaje.
Ai ekziston gjithmonë dhe vetëm Atij duhet t'i drejtohem.
Ai meriton të adhurohet dhe vetëm Atij duhet t'i drejtohem.

Ibrahimin a.s. nuk e djeg zjarri

Populli i Ibrahimit adhuronin idhuj të shumtë.

Një ditë derisa ata ishin në një festë, Ibrahim i theu të gjithë idhujt, përpos njërit i cili ishte më i madhi.

Kur shkuan, i panë të thyer idhujt e tyre, andaj pyetën:

- Kush i ka thyer?

Disa thanë:

- Kemi dëgjuar për një djalosh i cili quhet Ibrahim.

E morën Ibrahimin dhe e pyetën:

- A ti ke vepruar kështu me Zotat tanë?

Ibrahimi tha:

- Ndoshta kështu ka vepruar idhulli më i madhi i tyre?

Pyetni atë nëse ata zotat flasin!

Ata thanë:

- Po si ti pyesim, kur e dimë se ata nuk flasin.

Ibrahimi tha:

- Atëherë pse po i besoni ata që as nuk flasin e as nuk mund të dëgjojnë, e as nuk mund të bëjnë dobi.

Nga kjo përgjigje u hidhëruan dhe që të gjithë u pajtuan që të mbledhin dru, t'i thërrasin të gjithë njerëzit dhe të ndezin zjarr të madh dhe në të të digjej Ibrahim.

I përgatitën drutë, e vendosën Ibrahimin në mesin e druve.

Ibrahimi tha vetëm një fjali:

“HAS BIJALLAHU VE NIEMEL VEKIL”.

“Më mjafton Zoti, nuk ka mbrojtës më të mirë se Ai”.

Zoti i Madhëruar menjëherë i doli në ndihmë dhe e mbrojt Ibrahim duke i thënë zjarrit:

“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin.”

Njerëzit shikonin me habi se si zjarri nuk e digjte Ibrahimin.

Ai ulur në mes të zjarrit me një buzëqeshje të lehtë dhe të ëmbël.

Ibrahimi a.s. pastaj e falënderoi Zotin dhe vazhdoi rrugën e tij.

Ibrahimi a.s. me të atin

Babai i Ibrahimit i adhuronte idhujt.

Ibrahimi i tha babait të vet:

- O babai im, pse po adhuron atë që nuk dëgjon.

Pse po adhuron atë që nuk sheh.

Pse po adhuron atë që nuk ka mundësi të të bëjë dëm ty.

Pse po adhuron atë që nuk ka mundësi të bëjë kurrfarë dobie ty.

Babai tha:

- Këto janë Zota të prindërve dhe gjyshërve tanë.

Ibrahimi i tha:

- Më paso mua.

Unë të udhëzoj në rrugë të vërtetë dhe të sigurt.

Babai i tha:

- Ti je djali im, ti je i vogël të të dëgjoj.

Ibrahimi i tha:

- O babai im, mos e adhuro shejtanin.

Vërtet shejtani ka qenë dhe është i padëgjueshëm ndaj Zotit të gjithëmëshirshëm.

Babai i tha:

- Largohu se do të të mbys.

Ibrahimi me zemërgjerësi tha:

- Do t'i lutem Zotit tim që të të falë ty.

Ibrahimi u largua, duke e lënë prindin e tij të qetë në paqe por edhe duke shpresuar se një ditë do ta kuptojë realitetin dhe të vërtetën, kështu që të kthehet në rrugën e drejtë Islame.

Ibrahimi a.s. me mbretin

Nemrudi ishte mbret kriminel.

E konsideronte veten Zot.

Nemrudi mendonte se mbretëria është gjithçka.

Një ditë Nemrudi i tha Ibrahimit:

- Kush është Zoti yt?

Ibrahimi a.s. tha:

- Zoti im është Ai i cili ngjallë çdo gjë dhe i bën të vdesin gjallesat.

Nemrudi tha:

- Unë i ngjalli dhe i bëj të vdesin.

Nemrudi kishte dy njerëz të burgosur, njërin e dënoi me vdekje dhe tjetrin e liroi.

Ibrahimi tha:

- Vërtet Zoti e sjell diellin nga lindja, ndërsa ti nëse mundesh sille nga perëndimi.

Atëherë Nemrudi mbeti me gojë të hapur.

Zoti i madhëruar e dënoi Nemrudin, ashtu që ia dërgoi një mizë e cila i hyri në vesh.

Ajo mizë ditë e natë i lëvizte derisa nuk mund të flinte as ditën e as natën, as nuk mund të pushonte deri sa e rroku çmenduria.

Nemrudi u tha bashkëpunëtorëve që t'ia heqin kokën dhe t'ia vendosin një kokë prej arit.

Ata i thanë:

- Po ti atëherë do të vdesësh.

Nemrudi me çmendurinë e tij tha:

- Po a vdes Zoti?!

Kështu ia ndërtuan një kokë prej arit, ia sollën, ia prenë kokën dhe vdiq.

Zotit nuk mund t'i shpëtojnë pabesimtarët.

Thika nuk e pret Ismailin a.s.

Pasi kishte shpëtuar Ibrahim a.s. nga zjarri, iu lut Zotit:
“O Zoti im, më jep një djalosh të mirë dhe fisnik.”

Zoti i Madhëruar ia pranoi lutjen dhe me Haxheren i lindi një djalë i mirë.
Djalë e quajti Ismail.
Kur u rrit e donte shumë.
Ia mësonte atij namazin.
Kishte kujdes, e edukonte.

Ismaili ishte djalë shumë i mirë.
Ishte i zgjuar dhe i sjellshëm.
I shkonte përshtati babës së tij.

Ibrahim a.s. kishte parë ëndërr duke e bërë djalë kurban.
Në fillim mendoi se mos ishte ndërhyrje e shejtanit në ëndrrën e tij.
Ëndërr të njëjtë sheh për herën e dytë.
Edhe për herën e tretë e sheh të njëjtën ëndërr.
Atëherë e kuptoi se ishte urdhër prej Zotit të Madhëruar, sepse ëndrrat e peygamberëve janë realitet.

Shkoi te djalë e i tha:
- O biri im, vazhdimisht po shoh ëndërr duke të bërë kurban ty. Shiko, çka thua ti?

Ismaili me bindje të fortë e plot iman, tha:
- O baba im, vepra është siç je urdhëruar. Nëse dëshiron Zoti do të jem prej durimtarëve të vërtetë e do të sakrifikohem për Zotin e Madhëruar pa u hamendur fare.

U përgatit babai që ta pres djalë.
Ia lidhi duart.
E rëzoi për tokë.
E mori thikën e ia vuri në fyt.
Në atë moment Xhibrili ia solli një dash Ibrahimit e i tha:
Preje kurban dashin në vend të djalit.
Ti, tashmë e ke realizuar ëndrrën tënde.
Kështu Zoti i shpërblen bamirësit.
Kjo me të vërtetë është sprovim i fortë.

Lindja e Is'hakut a.s.

Sara ishte gruaja e Ibrahimit a.s.
Ajo ishte sterile.
Një ditë Ibrahim pa tre burra duke ecur.
U takua me ta dhe i gostiti.
Ibrahimi a.s. kishte dëshirë t'i nderonte mysafirët.
Shkuan së bashku në shtëpinë e tij.
Atyre u përgatiti ushqim.
Theri një viç të majmë dhe ju fërgoi mish mbi zjarr.
Ushqimin e ofroi para mysafirëve.
Ata nuk e shtrinë dorën mbi ushqimin.
Ai filloi të dyshoj dhe të frikësohet prej tyre.
Pastaj kuptoi se këta tre burra ishin melekë.
Ata ishin Xhibrili, Mikaili dhe Israfil.
Melekët kishin ardhur t'i tregojnë se do ta dënonin popullin e Lutit a.s.
Melekët e përgëzuan se do t'i lind një djalë.
Sara dëgjoi bisedën e tyre.
Ajo qeshi e habitur.
Sara tha:
- Si është e mundur të lind kur unë jam plakë?

Melekët i thanë:
Zoti është i Plotfuqishëm të krijojë çdo gjë në çdo kohë.

Pejgamberia e Is'hakut a.s.

Is'haku është djali i dytë i Ibrahimit a.s.
Nëna e Is'hakut është Sara.
Is'haku u rrit në duart e të atit, Ibrahimit a.s.
Në atmosferën e mrekullueshme të shpalljes.
Nën flladet e vizitave të Melekëve e bekimeve të tyre.
Dituria hyjnore ishin formuar më së miri te ai që në moshë të vogël.
Logjika e gjykimi i saktë ishin formuar më së miri te ai që në moshë të vogël.
Edukata nga i ati e kishin formuar më së miri karakterin e tij të mrekullueshëm.
Kur Is'haku u rrit e ishte tashmë i aftë për të përballuar këtë mision
edhe atij iu dha detyra e shenjtë e Pejgamberit.
Is'haku a.s. pa u lodhur ftoi njerëzit drejt mirësisë e besimit.
Pa u zbrapsur ftoi njerëzit drejt mirësisë e besimit.
Pa pushuar kurrë, shpjegoi fjalën e Zotit e rrugën e Tij.
Ftoi njerëzit drejt mirësisë e besimit.
Eci i bindur në rrugën e babait, të cilin Zoti e kishte zgjedhur Pejgamber.
Eci i bindur në rrugën e të vëllait, të cilin Zoti e kishte graduar me titullin Pejgamber.
Ibrahimi, Ismaili dhe Is'haku, që të tre ishin Pejgamber.

Jakubi a.s. është djali i Is'hakut a.s.

Jakubi a.s. rrjedh nga një familje pejgamberësh. Gjyshi i tij Ibrahim a.s. ishte pejgamber, axha Ismaili a.s. ishte pejgamber, baba Is'haku ishte pejgamber, e më vonë edhe djali Jusufi a.s. do të jetë pejgamber.

Jakubin a.s. jehuditë ndryshe e quajnë Israilë që d.m.th. Rob i Zotit.

Is'haku a.s. e kishte këshilluar Jakubin a.s. që të shkojë në Irak dhe të vendoset aty për të jetuar.

Jakubi a.s. e dëgjoji babin e tij dhe shkoi në Irak.

Atje u martua, filloi të kalojë jetë të lumtur.

Zoti i Madhëruar i kishte dhuruar dymbëdhjetë fëmijë.

Prej tyre:

Dhjetë fëmijë ishin me bashkëshorten Rahile.

Dy me bashkëshorten Leja.

Me bashkëshorten Leja ishin:

Jusufi dhe

Benjamini.

Jakubi kishte dashuri të madhe për Jusufin a.s.

Jakubi e donte shumë Jusufin a.s. dhe kujdesej shumë për të.

Kur dëgjoji prej djemve të tij se e kishte ngrënë ujku, ai me të drejtë nuk kishte besuar.

Nga pikëllimi dhe nga lotët për Jusufin a.s. iu kishin zbardhur sytë dhe gati ishte verbuar.

Kur mori vesh pas shumë viteve se Jusufi a.s. ishte gjallë shkoi në Egjipt.

Pasi lëmoi sytë me këmishën e Jusufit a.s. i erdhi shikimi.

Jaëkubi a.s. kishte shumë fëmijë.
Kur lindi Jusufi, Jusufi ishte djalë i hijshëm, i mençur dhe i dashur.
Kur lindi Jusufi, Jusufi ishte djalë i kujdesshëm.
Kur lindi Jusufi, Jusufi ishte djalë i sjellshëm.

Jakubi e kuptoi se do të jetë pejgamber.
Jakubi a.s. çdo ditë pas dreke e kishte zakon të ulej dhe rreth e rrotull i tubonte fëmijët e tij që të bisedonte me ta dhe t'i këshillonte.
Çdo herë në prehër e mbante Jusufin a.s.
Kjo sjellje ndikoi që vëllezërit të xhelozonin në Jusufin a.s.

Një ditë të bukur pranvere Jusufi a.s. i tha babës së tij:
- Unë në ëndërr i kam parë njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën duke më bërë sexhde.

Baba posa e dëgjoi i tha:
- O biri im, këtë ëndërr mos ia trego vëllezërve se do të të përgatitin kurthe.
Vërtetë shejtani është armik i hapur i njeriut.

Jusufi a.s. e dëgjoi babën e tij.
Nuk ua tregoi ëndrrën vëllezërve të tij.
Vëllezërit mendonin se baba i tyre e do më së shumti Jusufin a.s.
Vëllezërit e dinin se baba i tyre e do më së shumti Jusufin a.s.

Tradhtia e vëllezërve të Jusufit a.s.

Vëllezërit e Jusufit a.s. mendonin se baba i tyre e do më së shumti Jusufin a.s.

Njëri vëlla tha:

- Babai e do më së shumti Jusufin.

Tjetri tha:

- Ne e meritojmë të na dojë më shumë se atë.

I treti tha:

- Vërtetë baba është në humbje të sigurt.

I katërti tha:

- Ta vrasim Jusufin.

I pesti tha:

- Hidheni në fund të ndonjë bunari, e merr atë dikush prej udhëtarëve.

I gjashti tha:

- Ky i fundit është mendimi më i mirë.

Shkuan të gjithë së bashku e i thanë Jaëkubit – babës së tyre:

- Dërgoje Jusufin të luaj së bashku me ne dhe le të hajë pemë.

Babai tha:

- Frikohem mos e ha ujku.

Njëri prej tyre tha:

- Mos u friko, ne jemi shumë, do të kujdesemi dhe do ta ruajmë atë.

E morën vëllezërit Jusufin, e hodhën në një bunar të thellë,

u kthyen te babai i tyre e i thanë:

- Jusufin e ka ngrënë ujku, ja këmisha e përgjakur si dëshmi që të besosh se e flasim të vërtetën.

Jakubi tha:

- Durimi është më i vlefshëm, - dhe nuk kërkoi më shumë prej tyre.

Një karvan duke ardhur prej Sirisë për të shkuar në Egjipt u ndal për të pushuar dhe për të pirë ujë.

Një njeri e hodhi kovën në bunar kur papritmas u gëzua sepse kovën e nxori së bashku me Jusufin a.s.

Kur shkuan në Egjipt e shitën Jusufin a.s. me një çmim simbolik.

Jusufin a.s. e bleu ministri i Egjiptit.

Ministri i Egjiptit i tha gruas së vet të kujdeset sikur ta kishte djalë.

Jusufi a.s. në pallatin mbretëror

Një karvan shkonte prej Sirisë për në Egjipt.
 Ndalet për të pushuar dhe për të pirë ujë.
 Një njeri e hodhi kovën në bunar.
 Papritmas gëzohet sepse kovën e nxori së bashku me një fëmijë.
 Shkuan në Egjipt dhe e shitën Jusufin a.s. me një çmim simbolik.
 Jusufin a.s. e bleu ministri.
 Ministri i tha gruas së vet të kujdeset sikur ta kishte djalë.

Jusufi rritej pa brenga në pallatin e ministrit.
 Zoti i Madhëruar i kishte dhënë bukuri, dituri dhe mençuri.
 Bukuria e tij e shtyri gruan e ministrit që të dashurohej në të.
 Ajo filloi që të zbkurohej për Jusufin, mirëpo Jusufi a.s. nuk tregonte interesim për të.
 Kur e pa Zulejhaja se ai e refuzonte e ftoi në dhomën e saj.
 Ia mbylli derën e u përgatit që të flejë së bashku me Jusufin.

Jusufi a.s. iku me të shpejtë.
 Afër derës e takoi ministri.
 Ai e kuptoi se Zulejhaja ishte gabim e i tha Jusufit: largohu nga ajo, ndërsa gruan e tij e këshilloi që të kërkoi falje për gabimin e bërë.
 Në qytet përhapet lajmi.
 Lajmi e irritoi Zulejhanë edhe më shumë.
 Ajo i ftoi të gjitha gratë e qytetit.
 U dha nga një mollë dhe thikë për të qëruar mollët.
 Pastaj e urdhëroi Jusufin të hyjë në mesin e tyre.

Kur e panë bukurinë e Jusufit, mbetën gojëhapur dhe thanë:
 - Ky nuk është njeri, me siguri është Melek fisnik.
 I prenë duart e tyre e nuk e ndienin dhembjen.
 Filluan ta ndjejnë dhembjen vetëm atëherë kur doli Jusufi a.s.
Edhe pse Jusufi a.s. ishte i drejtë, tradhtarët e shtynë atë që pas një kohe të hidhet në burg.

Jusufi a.s. në burg

Jusufi a.s. ishte në pallatin shtetëror.
Padrejtësisht e arrestojnë dhe e vendosin në burg.

Në burg, Jusufi a.s. i takoi dy shokë.
Që të dy kishin parë nga një ëndërr.

Jusufi a.s. tha: - Më tregoni se çka keni parë në ëndërr.
I pari tha:
- Kam parë duke shtrydhë rrush dhe duke pirë verë.

I dyti tha:
- Kam parë se si mbaja bukë mbi kokë e shpendët hanin në të.

Jusufi a.s. të parit i tha:
- Do të shpëtosh dhe do t'i shërbesh ministrit.

Shokut të dytë i tha:
- Ti do të gjykohesh me vdekje.

Jusufi ishte komentues i saktë i ëndrrave.
Vërtetë ashtu siç i komentoi ëndrrat edhe ndodhi.
Shoku i parë u lirua.
Shoku tjetër u dënua me vdekje.

Interpretimi i ëndrrës së mbretit

Mbreti i Egjiptit kishte parë një ëndërr.
Shtatë lopë të dobëta duke i ngrënë shtatë lopë të majme.
Shtatë kallinj të thata duke i ngrënë shtatë kallinj të njoma.

E ftoi popullin t'ia komentojnë ëndrrën.
Askush nuk ishte në gjendje ta komentojë.

Njëri prej pallatit shtetëror kishte qenë në burg me Jusufin a.s.
I kujtohet se Jusufi ishte komentator i ëndrrave.
I kujtohet se Jusufi ia kishte komentuar ëndrrën e tij.
I thotë mbretit se në burg është një i burgosur i pafajshëm.
Ai i burgosur është komentues i saktë i ëndrrave.

Kur e ftuan Jusufin nga burgu u tha atyre:
- Shtatë vjet do të ketë shi.
E pastaj shtatë vjet tjera do të jetë shumë kohë e nxehtë dhe e vështirë për të jetuar.

Mbretit i pëlqeu ky komentim.
E liroi nga burgu.
E emëroi ministër të ekonomisë.
Jusufi ishte besnik dhe i drejtë.
Jusufi e qeverisi mirë ekonominë e vendit.

Jusufi a.s. ishte ministër i ekonomisë.

Ai punonte me përkushtim të jashtëzakonshëm.

Për çdo vjet të korrurat që i mbledhte i ruante në magazina për kohë të vështira.

Pas kohëve të mira, filloi thatësi.

Në Palestinë, aty ku ishin vëllezërit e Jusufit a.s. kishte mungesë të ushqimit.

Jakubi a.s. i dërgoi fëmijët në Egjipt për ushqim.

Vëllezërit e Jusufit a.s. shkojnë në Egjipt për ushqim.

Jusufi a.s. i njohte vëllezërit e tij, mirëpo ata nuk e njohnin.

Jusufi a.s. i pyet vëllezërit:

- Sa vëllezër jeni.

Ata i përgjigjen:

- Ne jemi njëmbëdhjetë vëllezër.

Jusufi a.s. u thotë:

- Po ku është i njëmbëdhjeti, ju këtu jeni dhjetë.

Ata thanë:

- Kemi një vëlla të vogël, mirëpo babai frikohet për të dhe nuk e ka lejuar të vijë me ne.

Jusufi u tha:

- Kësaj radhe merreni ushqimin.

Nëse nuk e sillni vëllanë e vogël, herën tjetër nuk do të ketë ushqim për juve.

Vëllezërit e Jusufit a.s. u kthyen në shtëpinë e tyre me plot ushqim.

Ata ishin të gëzuar.

Po ashtu edhe baba i tyre Jaëkubi a.s. u gëzua.

Fëmijët e Jakubit a.s. shkuan për ushqim.

Aty administrator i depove ishte Jusufi a.s.

Edhe pse ishte vëllai i tyre, Jusufi i njihte ndërsa ata nuk e njihnin.

Kur shkuan te depot e ushqimit, Jusufi a.s. i pyeti sa vëllezër jeni?

Ata i përgjigjen:

- Ne jemi njëmbëdhjetë vëllezër.

Jusufi a.s. u thotë:

- Po ku është i njëmbëdhjeti, ju këtu jeni dhjetë.

Ata thanë:

- Kemi një vëlla të vogël, mirëpo babai frikohet për të dhe nuk e ka lejuar të vijë me ne.

Jusufi u tha:

- Kësaj radhe merreni ushqimin.

Nëse nuk e sillni vëllanë e vogël, herën tjetër nuk do të ketë ushqim për juve.

Vëllezërit e Jusufit a.s. u kthyen me plot ushqim në shtëpitë e tyre.

Ata ishin të gëzuar, po ashtu edhe Jaëkubi a.s. u gëzua.

Ky gëzim ishte i shkurtër, sepse kur i thanë djemtë Jaëkubit a.s. se herën tjetër nëse nuk e marrin Benjaminin, vëllanë e vogël, nuk do t'u jep ministri i Egjiptit ushqim,

Jakubi a.s. u brengos dhe mendoi shumë. Pastaj u tha atyre:

- Vetëm nëse betoheni dhe më premtoni, do ta dërgoj me juve Benjaminin në Egjipt.

Vëllezërit u betuan se do ta ruajnë vëllanë e tyre.

Jaëkubi a.s. tha:

- Allahu është ruajtësi më i miri.

Ai është më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.

Pastaj u gëzuan të gjithë.

Në fund Jaëkubi a.s. u tha:

- Pasi të shkoni në Egjipt, mos hyni nga një derë, por hyni nga dyer të ndryshme.

Shkuan vëllezërit në Egjipt me vëllanë e tyre Benjaminin.

Vepruan sikur i kishte këshilluar babai i tyre.

Pasi u takua Jusufi a.s. me Benjaminin i tha atij:

- Unë jam vëllai yt.

I përmalluar Benjamini për Jusufin a.s. e përqafoi me të fortë.

Jusufi a.s. i tha:

- Dëgjo. Mos i trego askujt.

Ti do të ndalesh me mua në Egjipt kinse për të vuajtur një dënim.

U kthyen vëllezërit e pikëlluar në shtëpi, i thanë babait të tyre:

- O baba, djali yt ka vjedhur. Por Benjamini në të vërtetë nuk kishte vjedhur.

Ne e flasim të vërtetën, por ti prapë nuk po beson.
Jaëkubi a.s. duroi e duroi, duroi më shumë se kurdoherë tjetër.
Ishte i bindur se Zoti do ta shpërblente për durimin e tij.
Ishte i bindur se Zoti do ta shpërblente për humbjen e djemve të tij.
Ishte i bindur se Zoti do t'ia kthente të dy djemtë e humbur.

Durimi shpërblehet

Jakubi a.s. mërzitej për djalin e tij të humbur.
 Ai qante për të, por qante kur ishte i vetmuar.
 Nga të qarit e tepërt Jakubi verbohet.
 Fëmijët e qortonin e i thoshin se ti po mërzitesh shumë e kjo të ka verbuar.

Atëherë Jaëkubi a.s. tha:

- O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni në Egjipt për Jusufin dhe vëllanë e tij.
- O bijtë e mi, mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut.
- O bijtë e mi, vetëm populli pabesimtar e humb shpresën në Allahun.

Kur shkuan kësaj radhe në Egjipt.

Jusufi a.s. i pyeti:

- A e dini si keni vepruar me Jusufin dhe vëllanë e tij?

Vëllezërit me habi thanë:

- Nga e di ti për Jusufin?

Jusufi a.s. tha:

- Sepse Jusufi jam unë, e ky është vëllai im.

Vëllezërit e ulën kokën, u turpëruan.

E pranuan gabimin e tyre dhe
 kërkuan falje nga Jusufi a.s.

Jusufi tha:

- E lus Allahun të jua falë gabimin. Ai është më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.
- Kthehuni në shtëpi.
- Merrni këtë këmishë dhe lëmoni sytë e babait dhe do t'i kthehet shikimi.

Vërtetë ndodhi mrekullia e Allahut. Jakubit a.s. i erdhi shikimi.

Jakubi së bashku me djemtë dhe familjen e tij shkoi në Egjipt te Jusufi a.s.
 Pastaj edhe vendosi të jetojë atje.

Jusufi a.s. i priti me zemërgjerësi e i tha babait të tij:

“O babai im, kjo është domethënia e ëndrrës sime të mëparshme.

Zoti im tani e bëri realitet.”

Firauni dhe mbytja e fëmijëve meshkuj

Faraoni ishte mbret i Egjiptit.

Ai kishte parë ëndërr se do të lindë një djalë nga mesi i Beni Israilëve.

Ai djalë kur do të rritej do t'ia merrte fronin.

Për këtë arsye urdhëroi ushtrinë e tij që çdo fëmijë i cili lindë djalë nga mesi i Beni israilëve të mbytet.

Ushtarët shkuan në një shtëpi tjetër aty pranë, ku një muaj më parë kishte lindur një djalë.

Ata e thyen derën dhe iu afruan lehonës duke e pyetur:

- A ti ke lindur para një muaji?

Gruaja u përgjigj:

- Po. Përse, çfarë ka ndodhur?

Ushtarët e pyesin:

- Ku e ke djalin?

Gruaja i pyet:

- Përse e doni djalin tim?

Ushtarët përsëri e pyesin:

- Ku është djali?

Gruaja e merr djalin dhe ua tregon.

Në çast, njëri nga ushtarët nxori thikën dhe ndër sy të nënës dhe të babait e theri djalin pa pikë mëshire.

Më pas e hodhën përtokë dhe të gjithë u larguan, duke lënë pas vajin dhe panikun.

Të gjithë banorët e lagjes u tronditën nga kjo ndodhi dhe mbetën pa fjalë.

Banorët e lagjes iu drejtuan babait të foshnjës që sapo e kishin therur:

- Çfarë ke bërë që të ndodhi kjo?

Ky ishte një krim i shëmtuar sepse Firauni frikohej se ndonjëri prej foshnjave do t'ia merrte fronin.

Lindja e Musait a.s.

Faraoni ishte mbret i Egjiptit.

Ai kishte parë ëndërr se do të lindë një djalë nga mesi i Beni Israilëve.

Ai djalë kur të rritej do t'ia merrte fronin.

Për këtë arsye urdhëroi ushtrinë e tij që çdo fëmijë i cili lindë djalë nga mesi i Beni israilëve të mbytet.

Në këtë kohë të vështirë lindi Musai a.s.

Nëna e Musait u frikua se do t'ia mbytnin djalin në djep.

Posa lindi djalë, e përqafoi,

E ledhatoi siç i ledhatojnë nënat fëmijët e tyre.

E puthi në faqe siç i puthin nënat fëmijët e tyre.

E mbështjelli mirë dhe e futi në një sënduk.

Sëndukun e hodhi në lumin Nil.

Nëna i thotë vajzës së saj:

- Përcille deri ku do të shkojë sënduku.

Për habi sënduku lundroi drejtë në pallatin mbretëror të Faraonit.

Rojtarët e panë sëndukun dhe ia sollën mbretëreshës.

Ajo kur e hapi sëndukun u gëzua pa masë kur pa se në të ishte foshnja e porsalindur.

E mori në përqafim.

Shkoi te mbreti Faraon e i tha:

- Këtë djalë do ta ruajmë.

Këtë djalë do ta rrisim si fëmijën tonë e askush nuk do të na hetojë.

Faraoni pranoi dhe Musai a.s. u rrit në pallatin e tij.

Musait a.s. i kthehet nëna

Kur lindi Musai, Faraoni i mbyste fëmijët e beni israilëve.
 Nëna e Musait për ta shpëtuar fëmijën e saj, e kishte vendosur Musain në sënduk dhe e kishte lëshuar në lumin Nil.
 Sëndukun e gjen mbretëresha e Egjiptit.
 Ajo e mori në përkujdesje dhe vendosi që ta rritte.
 Ajo kërkonte grua me pagesë për t'i dhënë qumësht fëmijës.
 Shkoi një grua për t'i dhënë gjë fëmijës.
 Fëmija nuk e pranoi gjirin e asaj gruaje.

Shkoi edhe një grua për t'i dhënë gjë fëmijës
 Fëmija prapë nuk e pranoi edhe gjirin e asaj gruaje.

Gratë nga qyteti shkonin një nga një për t'i dhënë gjë fëmijës.
 Musai a.s. nuk e pranonte gjirin e asnjë gruaje.

Në atë moment paraqitet motra e Musait a.s.
 Motra e Musait a.s. i tha mbretëreshës:
 - E di një grua në fund të qytetit.
 Ndoshta gjirin e saj do ta pranojë foshnja.

Mbretëresha pranoi.
 Motra e Musait a.s. shkon te nëna e saj dhe e sjell në Pallat.
 Kur shkon nëna e Musait a.s., ai e pranoi gjirin.
 Askush nuk e kuptoi se ajo ishte nëna e tij.
 Pikëllimi iu largua edhe nënës së Musait a.s.
 Në të njëjtën kohë edhe Musai a.s. u rrit në gjirin e nënës së tij.

Kaluan shumë vite, Musai a.s. u rrit.
 Të gjithë mendonin se ai ishte djali i Faraonit.
Por vet Musai a.s. ishte i sigurt se ishte biri i Beni Israilëve.

Musa a.s. dhe personi i familjes

Musa a.s. u rrit në pallatin e Firaunit.

Një ditë prej ditëve Musai a.s. kalonte përmes qytetit.

Pa se si një person i familjes së Faraonit ishte ngatërruar me një të familjes së Beni Israilëve.

Musai a.s. pa hamendje i ndihmoi Beni Israilit.

I ra me grusht personit të familjes së Faraonit.

Kur i ra grusht, personi i familjes së Firaunit ra i vdekur për tokë.

Musai a.s. nuk kishte qëllim për ta mbytur, mirëpo atij i ra pika në zemër nga inati dhe vdiq.

Për fat askush nuk e hetoi se Musai a.s. e kishte mbytë.

Ditën tjetër ndodhi prapë një ngatërrim.

I njëjtit person i Beni Israilëve ngatërrohet me një person tjetër të familjes së Faraonit.

Kësaj radhe Musai a.s. ishte më i kujdesshëm.

Iu kthye personit të Beni Israilëve e i tha:

- Me të vërtetë ti je ngatërrestar.

Ai nga frika i tha:

- A dëshiron të më mbytësh sikur që e mbyte dje personin nga familja e Faraonëve!?

Këtë fjalë e dëgjuan ata që ishin afër.

Në qytet përhapet lajmi se Musai a.s. e kishte mbytur një person nga familja e Faraonit.

Kur mori vesh Faraoni për këtë lajm urdhëroi ushtrinë për ta zënë Musën a.s. për ta mbytur.

Një ushtar i Faraonit i cili besonte në Zotin, fshehtazi shkoi me të shpejtë te Musai e i tha:

- **Ik nga ky vend e shpëto se kanë vendosur të të vrasin.**

Musai a.s. iku me të shpejt nga mbretëria e Firaunit dhe shpëtoi.

Musai a.s. në qytetin Medjen

Firauni kishte marrë vendim për ta ekzekutuar Musain a.s.
Musai a.s. nga frika se do të mbytej, në mesnatë largohet me të shpejtë nga Egjipti.
Pasi u largua nga Egjipti, u nis në drejtim të Medjenit.

Rruga ishte e vështirë.
Ishte i lodhur dhe i rraskapitur.
Ndalet pranë një lisi për të pushuar.

Papritmas i pa dy vajza me bagëti dhe u thotë:
- Çka keni, çka po pritni?

Vajzat thanë:
- Babai ynë është plakur, bagëtia jonë nuk mund të pijë ujë tek burimi deri sa të shkojnë barinjtë.

Musai a.s. e kuptoi se vajzat nuk mund të përziheshin me djemtë.
Mori bagëtinë e i çoi te burimi dhe bagëtia piu ujë.
Pastaj ktheu bagëtinë të vajzat.

Vajzat morën bagëtinë dhe shkuan në shtëpi.

Musai a.s. u ul pranë një lisi e iu lut Zotit:
O Zoti im më furnizo me të mirat Tua.

Musai a.s. te Shuajbi a.s.

Musa a.s. u ndihmoi vajzave të Shuajbit a.s.

Njëra prej vajzave të Shuajbit a.s. shkoi te Musai a.s. e i tha:

- Të fton babai ynë, që të të shpërblejë për shkak se na ndihmove që t'i japim bagëtisë ujë.

Musai a.s. shkoi në shtëpinë e tyre.

Ndërkohë që Musai po ngrihej e po u kërkonte leje të ikte, vajza e vogël iu afrua të atit dhe i tha:

- O baba, a nuk kërkoje vazhdimisht një burrë besnik e të fuqishëm për të të ndihmuar në punët e tua? Ja ku të erdhi te dera. Merre Musain në punë, atë e ke shumë të përshtatshëm, edhe besnik, edhe të fuqishëm.

Shuajbi e pyeti:

- E ku e di ti se është i fuqishëm?

Vajza i përgjigjet:

- E pashë kur ngriti i vetëm një shkëmb që mezi e lëvizin dhjetë burra.

Baba e pyet vajzën:

- Mirë i fuqishëm, po nga ta dimë se është besnik?

Vajza i përgjigjet:

- Kur erdhëm në shtëpi, nuk deshi të ecte pas meje që unë të mos ndihesha keq. Kur flet me të, ai skuqet dhe nuk i ndan sytë nga toka.

Shuajbi u kthye nga Musai, që po bëhej gati të dilte, e i tha:

- Musa, kam një propozim për ty. Në qoftë se rri këtu e bëhesh ndihmësi ynë për tetë vjet, do të të martoj me njëren prej vajzave të mia e do të të mbaj si bir.

Po ndenje dhjetë vjet, kjo tregon mirësinë e bujarinë tënde.

Po unë nuk dua të të mbaj të lidhur, ti e di vetë. Po as mirësia, as bujaria ime, nuk ka për të të munguar.

Musait a.s. i qeshi fytyra. Ky propozim ishte dashamirësia e Zotit vetë!

Ai nuk ngurroi aspak dhe pranoi.

Ai u martua me vajzën e vogël dhe për dhjetë vjet me radhë i shërbeu Shuajbit.

Dhjetë vite të cilat i kaloi pranë Shuajbit ishin një periudhë shumë e rëndësishme në formimin e Musait a.s.

Musai a.s. në kodrën e shenjtë Tuva

Musai a.s. është peygamber i Zotit.
Edhe Shuajbi a.s. është peygamber i Zotit.
Musai a.s. kishte qëndruar te Shuajbi a.s. dhjetë vite.

Pas dhjetë viteve Musai a.s. largohet nga qyteti Medjen.
Musai a.s. dëshironte të kthehej në Egjipt.
Kaloi nëpër male e shkretëtira.

Në një natë të ftohtë Musai a.s. ishte në një kodrinë.
Papritmas nga lartë u pa një dritë që shkëlqente.
Musa a.s. i tha gruas së tij:
- Pusho pak deri sa të shkoj atje të shoh mos është ndokush, ta marr pak zjarr e pastaj të ngrohemi ose ndokush edhe na e tregon rrugën.

Kur shkoi Musai a.s. te ajo dritë e fortë dëgjoi një zë:
O Musa, Vërtetë unë jam Zoti yt.
Ti je në luginën e shenjtë Tuva.
Hiqi nallanet që i ke mbathur.

Musai a.s. filloi të frikohet, i hoqi nallanet dhe u përqendrua që të dëgjojë.

Atëherë dëgjoi përsëri fjalët:
Unë të zgjodha ty për peygamber, prandaj dëgjo mirë çka po të shpallet.
Vërtetë, vetëm unë jam Allahu, nuk ka Zot përpos Meje.
Mua më adhuro dhe fale namazin për të më kujtuar Mua.

Dy mrekullitë e Musait a.s.

Musai a.s. shkon në një kodrinë.
Ajo kodrinë në shkretëtirë quhej Tuva.
Aty Musai a.s. bisedoi me Zotin e Madhëruar.
Zoti i Madhëruar e pyeti Musain a.s.:
- Çka ke në dorë o Musa?

Musai a.s. iu përgjigj:
- Kam shkopin me të cilin e përdori për dhentë.
Me shkopin kryej edhe punë të ndryshme.

Zoti i Madhëruar i tha:
- Hidhe atë ç'ke në dorë o Musa.

Kur e hodhi shkopin, ai u shndërrua në gjarpër të vërtetë.
Musa a.s. filloi të frikohej.
Zoti i Madhëruar i tha:
- Mos u friko, por kape.

Pastaj Zoti i Madhëruar i tha Musait a.s.:
- Fute dorën në xhepin tënd.
Kur Musai a.s. e futi dorën në xhep, dora filloi t'i shndriste nga drita e bardhë.

Zoti i Madhëruar i tregoi Musait a.s. se këto dy mrekulli t'i ofrova që të shkosh te Faraoni sepse ai i kishte tejkaluar kufijtë.

Zoti i Madhëruar i tregoi Musait a.s. se këto dy mrekulli t'i ofrova që të shkosh te Faraoni për ta drejtuar në rrugë të drejtë.

Musai a.s. në Egjipt

Musai a.s. shkoi për në Egjipt te Faraoni.

Haruni është vëllai i Musait a.s.

Që të dy ishin Pejgamber.

Musai a.s. dhe Haruni a.s. u takuan në breg të lumit Nil.

Kur u takuan e përqaftuan njëri-tjetrin.

Pastaj Musai a.s. i tha vëllait:

- Eja të shkojmë tek Faraoni sepse Allahu na ka ngarkuar me këtë detyrë!

Musai a.s dhe Haruni a.s. shkuan te Faraoni dhe i thanë:

- Ne jemi pejgamberë, liroi Beni Israilët, mos i mundo.

Kthehu në rrugë të drejtë.

Faraoni i tha Musait a.s.:

- A mos ke ndonjë argument se vërtetë ti je pejgamber!?

Musai a.s. e gjuajti shkopin e ai u shndërrua në gjarpër,

Pastaj e nxori dorën nga xhepi e ajo shndriste si yll i shkëlqyer.

Faraoni me shokët e tij menduan se mos është magji.

Ata i ftuan magjistarët dhe caktuan një ditë që të tubohen njerëzit dhe të shohin se kush do të fitojë.

Erdhi dita kur u takuan magjistarët me Musën a.s.

Magjistarët i gjuajtën litarët.

Litarët dukeshin sikur të ishin gjarpërinj, por në të vërtetë nuk ishin gjarpërinj.

Musai a.s. e gjuajti shkopin.

Shkopi u shndërrua në gjarpër të vërtetë dhe i gëlltiti litarët që dukeshin si gjarpërinj.

Magjistarët kuptuan mrekullinë e Musait a.s. dhe ranë në sexhde e thanë:

- Ne besojmë në Zotin e të gjithë botëve.

Faraoni u zemërua dhe ju tha magjistarëve:

- Do të ju dënoj me një dënim të fortë pse besuat.

Kërcënim i Firaunit nuk ndikoi te magjistarët.

Magjistarët thanë:

- O Zoti ynë na jep durim.

O Zoti ynë na bën që të vdesim musliman.

Çdo vështirësi ka lehtësinë

Musai a.s dhe Haruni a.s. shkuan te Firauni.

Kur shkuan te Faraoni i thanë:

- Ne jemi pejgamberë, liroji Beni Israilët, mos i mundo.
Kthehu në rrugë të drejtë.

Firauni nuk pranonte t'i lironte beni Israilët.

Për këtë arsye Zoti i Madhëruar i solli Musait a.s. mrekulli të shumta:

- Karkalecat bënin zhurmë tërë natën dhe nuk i linin të flenë.
- Bretkosat bënin zhurmë tërë natën dhe nuk i linin të flenë.
- Morrat u ngjiteshin në trup dhe nuk i linin të qetë.
- Gjaku iu paraqitej në ujë dhe nuk mundnin të pinë ujë.
- Nuk mund të flinin dhe të pushonin.
- Nuk mund të qëndronin pa ushqim.
- Nuk mund të jetonin pa ujë.

Të gjitha këto e detyruan Faraonin të dorëzohet.

Firauni i tha Musait a.s.:

- O Musa, merri Beni Israilët e largohu nga këtu, vetëm na lërë neve të qetë.
Musai a.s. i mori Beni Israilët e u nis të largohej nga Egjipti.

Më pas Firauni prapë vendosi ta ndjek Musain a.s.

Përgatiti ushtrinë dhe u nis për ta zënë Musain a.s. dhe Beni Israilët.

Musai a.s. arriti në breg të detit, ndërsa Firauni me ushtrinë e tij e ndiqte pas.

Atëherë Zoti i Madhëruar i tha Musait a.s. që t'i bjerë detit me shkop.

Musai a.s. i ra detit me shkop, deti u ça në dysh.

Musai a.s. kaloi në anën tjetër të detit.

Firauni me ushtrinë e tij u nisën pas tij.

Kur arriti Faraoni në mes të detit.

Deti u bashkua dhe e përmyti Faraonin me ushtrinë e tij.

Musai a.s. me Beni Israilët shpëtuan.

Shpërthimi i ujit nga guri

Një ditë prej ditëve, populli i Musait a.s. u gjend në gjendje shumë të vështirë.
U ballafaqua me krizë natyrore, saqë nuk kishte ushqim.
Përroskat dhe lumenjtë ishin shterur.
Kafshët kishin ngordhur.
Bimët ishin tharë.
Vdekja e merrte çdo ditë nga një qytetar.

Ata nuk kishin zgjidhje tjetër, pos të kërkojnë që Musai a.s. t'i lutej Zotit që të bie shi.
Musai a.s. e pranoi kërkesën e tyre dhe iu lut Zotit të Lartmadhëruar duke i ngritur duart lart për të zbritur shi nga qielli.

Zoti e urdhëron Musain a.s. që me shkop t'i bie gurit.
Musai a.s. i bie gurit dhe menjëherë prej gurit kanë shpërthyer dymbëdhjetë burime.
Të gjithë pinin ujë, dhe të gjithë mahniteshin!

Kjo është fuqia e Allahu të Lartmadhëruar.
Me këtë Allahu i Lartmadhëruar ka dashur që të na mësojë se Ai është Sundimtari absolut, Gjykuesi absolut, Caktuesi i çdo çështjeje.
Allahu i Lartmadhëruar me këtë ka dashur që të na mësojë se Ai është Gjykuesi absolut.
Allahu i Lartmadhëruar me këtë ka dashur që të na mësojë se Ai është Caktuesi i çdo çështjeje.
Besimtari është krijesa më e lumtur në tokë, sepse ai ka besim dhe bindje të plotë në Allahun e Lartmadhëruar dhe ka bindje të plotë në fuqinë e Tij.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

**“Dhe përkujto atëherë kur Musai a.s. kërkoi ujë për popullin e tij.
Dhe Ne i thamë: Bjeri me shkopin tënd gurit.
Ai i ra: Dhe menjëherë shpërthyen dymbëdhjetë burime.
Dhe secili fis e dinte vendburimin e tij.
Hani dhe pini prej furnizimeve të Allahut.
Mos u bëni shkatërrimtarë në fytyrën e tokës”.**

Shkopi dhe deti

Musai a.s. dhe Haruni a.s. kishin mbledhur izraelët dhe ishin larguar nga Firauni.
 Firauni me ushtrinë iu vu nga pas që t'i vriste.
 Musai a.s. kishte arritur në breg të Detit të Kuq.
 Nga larg, dukeshin flamurët e ushtrisë së Firaonit.
 Izraelët që ishin me Musain i pushtoi frika.
 Ishin momente shumë të rënda.
 Para kishin detin. Prapa ushtrinë armike.
 Nuk kishin as forca, as armë për të luftuar.

Musai a.s. i qetësoi duke u thënë.
 - Mos u trembni, Zoti i botëve është me ne, Ai do të ma tregojë rrugën.

Zoti e urdhëroi Musain:
 - Preke detin me shkopi!

Sapo shkopi i Musait preku detin, ujërat e tij u ndanë më dysh.
 Hapet një rrugë mu në mes të detit.
 Musai a.s. nga para dhe Izraelitët nga pas, nisën të ecnin nëpër rrugën e hapur në det.
 Ishte një mrekulli e jashtëzakonshme!
 Dallgët shkrumbonin e hidheshin, por vetëm anë rrugës. Përgjatë kalimit, sikur i mbante një dorë e padukshme dhe ata as që i lagnin udhëtarët.
 Kur arriti Faraoni në breg të detit u ngri nga habia.
 Një tjetër mrekulli. Një rrugë kalimi, e thatë, mu në mes të detit!
 Në fillim u tremb, por pastaj ra pre e inatit dhe e zemërimit të vet. I urdhëroi të ndiqnin rrugën.
 Faraoni para dhe ushtria me kuaj nga pas, nisën të ecnin nëpër rrugën ku pak më parë kishte kaluar Musai a.s. me njerëzit e vet.
 Ushtria e Faraonit kishte arritur mu në mes të detit.
 Zoti e urdhëroi detin të kthehej në gjendjen e mëparshme.
 Faraoni dhe ushtria e tij gjigante gjendeshin në fund të detit.
Deti i kishte përpirë. As edhe një gjurmë, as nga faraoni, as nga ushtria e tij.

Karuni ka qenë prej popullit të Musait a.s.
 Ai ka qenë edhe prej familjes së Musait a.s..
 Ai e dinte Tevratin përmendësh.
 Kur e këndonte Tevratin, e këndonte me zë të bukur.
 Karuni e shtypte popullin e vet ngase kishte shumë pasuri.
 Karuni kishte aq shumë pasuri saqë një grup njerëzish mezi mund t'i mbanin çelësat e magazinave të pasurisë.

Populli i vet i tha:

- Mos u kreno aq fortë sepse Allahu nuk i do të shfrenuarit!

Musai a.s. i ka thënë:

- Dhe bën të mira, ndihmoju të tjerëve ashtu siç Allahu të ka bërë mirë ty, e mos bën të këqija në tokë.

Zoti Lartmadhëruar e urdhëroi që të japë 1 % zekat.

Karunit i dukej shumë.

Karuni jo vetëm që ka refuzuar ta japë zekatin, por u thoshte tjerëve:

- Musai çdo gjë që ju ka urdhëruar e keni dëgjuar, por tash mos e dëgjoni.

Atëherë Zoti i Lartmadhëruar i thotë Musait a.s. që të bëjë dua që të fundoset Karuni me tërë pasurinë e tij.

Musa a.s. u lut:

- Oj tokë fundose Karunin dhe pasurinë e tij.

Lutja e Musait a.s. është pranuar.

Karuni së bashku me pasurinë e tij është fundosur në tokë, për arsye se nuk e ka dhënë zekatin.

Karunin së bashku me pasurinë e ka mbuluar dheu për së gjalli, për arsye nuk i ka ndihmuar të tjerëve.

Karuni së bashku me pasurinë e tij është fundosur në tokë sepse nuk e ka dëgjuar urdhrin e Zotit.

Musai a.s. ka qenë peygamber.

Gjatë një udhëtimi është shoqëruar me Hidrin a.s.

Në atë udhëtim ka mësuar prej Hidrit çështje shumë interesante sepse Hidrit a.s. i është dhënë cilësia e mëshirës dhe dituria prej Allahut.

Duke udhëtuar Musai a.s. dhe Hidri arrijnë në një qytet.

Aty kërkojnë ushqim dhe vendstrehim.

Banorët ishin koprrac, ata as nuk u japin ushqim dhe as nuk i strehojnë.

Duke kaluar në anën tjetër të qytetit e shohin një mur të vjetër, i cili ishte duke u rrëzuar, e që rrëzimi i atij muri do t'i dëmtonte kalimtarët dhe do të rrezikonte gjendjen e banorëve.

Hidri a.s. i thotë Musaut a.s. që ta riparojnë atë mur.

Pasi që e riparojnë Musai a.s. i thotë:

- Po pasi e riparuam atëherë le të kërkojmë kompensim.

Hidri i thotë:

- Jo, nuk do të kërkojmë kompensim sepse murin e kam riparuar për arsye tjetër.

Arsyeja është se nën mur ishte vendosur një thesar i dy jetimëve.

Rrëzimi i atij muri do të zbulonte thesarin e tyre,

Atë thesar do ta merrnin ai popull koprrac. Kështu që pas riparimit, fëmijët jetimë do të rriten.

Pasi që të rriten Zoti do t'ua mundësojë atyre dy jetimëve që të arrijnë deri te zbulimi i atij thesari.

IBRAHIMI A.S.	7
IBRAHIMIN A.S. NUK E DJEG ZJARRI.....	8
IBRAHIMI A.S. ME TË ATIN	9
IBRAHIMI A.S. ME MBRETIN	10
THIKA NUK E PRET ISMAILIN A.S.	11
LINDJA E IS'HAKUT A.S.	12
PEJGAMBERIA E IS'HAKUT A.S.	13
JAKUBI A.S.	14
JUSUFI A.S.....	15
TRADHTIA E VËLLEZËRVE TË JUSUFIT A.S.	16
JUSUFI A.S. NË PALLATIN MBRETËROR	17
JUSUFI A.S. NË BURG	18
INTERPRETIMI I ËNDRRËS SË MBRETIT	19
JUSUFI A.S. MINISTËR	20
BENJAMINI	21
DURIMI SHPËRBLEHET	23
FIRAUNI DHE MBYTJA E FËMIJËVE MESHKUJ	24
LINDJA E MUSAIT A.S.	25
MUSAIT A.S. I KTHEHET NËNA	26
MUSA A.S. DHE PERSONI I FAMILJES.....	27
MUSAI A.S. NË QYTETIN MEDJEN.....	28
MUSAI A.S. TE SHUAJBI A.S.....	29
MUSAI A.S. NË KODRËN E SHENJTË TUVA	30
DY MREKULLITË E MUSAIT A.S.	31
MUSAI A.S. NË EGJIPT	32
ÇDO VËSHTIRËSI KA LEHTËSINË.....	33
SHPËRTHIMI I UJIT NGA GURI	34
SHKOPI DHE DETI	35
KARUNI.....	36
MËSHIRA DHE KUJDESI NDAJ JETIMËVE	37